



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5447 Prot

Tiranë, më 31.08 2023

UDHËZIM

Nr. 19 datë 31.08 2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.03.2020, “PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 91 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020, “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) Shkronja “gj”, e pikës 1 të Kreut II, të riformulohet si më poshtë:

“gj) Emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shkrim dore. Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një IAL-je vendoset emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shkrim dore.”

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

EVIS KUSHI

